



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 417/4 prot.

Elbasan, më 23.02.2024

VENDIM

Nr. 10, datë 23.02.2024

Për

miratimin e fondit nga të ardhurat e institucionit (në programin e kërkimit shkencor për mbështetje studentore) të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", që financohen nga UE

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM-s nr. 386, datë 01.06.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, udhëzimit të MAS nr. 30, datë 04.11.2022 për këtë qëllim, Vendimit të Senatit Akademik nr. 4, datë 31.01.2024 "Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 4, datë 10.02.2024 "Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik në mbledhjen e Tij të datës 23.02.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin në vlerën **9,000,000** lekë nga të ardhurat e institucionit (në programin e kërkimit shkencor për mbështetje studentore) të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", që financohen nga UE për vitin 2024 për 25 studentë përfitues, sipas listës bashkëlidhur.
2. Vendimi i Senatit Akademik i dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për procedurat miratimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Skender Topi

